

**VENDIM**  
**Nr.1497, datë 19.11.2008**

**PËR SHTYPJEN E LETRAVE ME VLERË**

*(Ndryshuar me VKM-të nr.150, datë 3.3.2010, nr.277, datë 6.4.2011, nr. 475, datë 25.7.2012, nr. 393, datë 18.6.2014, nr. 373, datë 21.6.2023; nr. 431, datë 19.7.2023; nr. 273, datë 2.4.2024; nr. 84, datë 5.2.2025)*  
*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shtypja e letrave me vlerë realizohet nga Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, sh.a, me kapital shtetëror, në varësi të Ministrit të Financave.

*Kur Shtypshkronja e Letrave me Vlerë nuk ka kapacitet teknologjik për shtypjen e biletave të lojërave të fatit ato mund të shtypen në shtypshkronja brenda ose jashtë vendit, sipas një procedure të përcaktuar me udhëzime të Ministrit të Financave.*

*Me pamundësi të kapacitetit teknologjik nënkuptohet mungesa e software-ve dhe hardware-ve të nevojshëm për shtypjen e biletave të lojërave të fatit.*

*Me marrjen e kërkesës për shtypjen e biletave të lojërave të fatit, për të cilat Shtypshkronja e Letrave me Vlerë dyshon se nuk ka kapacitetin e duhur teknologjik të shtypjes, ajo mbledh bordin drejtues, i cili analizon ekonomikisht në mënyrë të bollësishtme, pamundësinë e shtypjes së këtyre biletave dhe argumenton pamundësinë e kthimit ekonomik, nëse do të investohet për blerjen e teknologjisë së munguar për këto raste. Në përfundim, bordi drejtues i Shtypshkronjës së Letrave me Vlerë merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit, i cili i komunikohet operatorit kërkuar. Në vijim, operatori mund të procedojë me nënshkrimin e kontratës për shtypjen e këtyre biletave në shtypshkronja të akredituara, brenda ose jashtë vendit, dhe vë në dijeni institucionin mbikëqyrës të aktivitetit të tij.*

2. Letra me vlerë, në kuptimin e këtij vendimi, do të vlerësohen pullat fiskale, biletat e lojërave të fatit, biletat e transportit rrugor dhe atij bekurudhor, kuponët për dokumente biometrike, pullat e postës shqiptare, si dhe diplomat e maturës shtetërore, bileta, procesverbale, akte kontrolli, vendim për kundërvajtjen administrative, procesverbal i konstatimit të kundërvajtjes administrative, akt verifikimi, vendim dënimi, vërtetim transporti, bileta për hyrje në zonat e mbrojtura/parqe kombëtare për invalidë dhe automjete, fatura, raporte mjekësore, receta me rimbursim 100%, receta me rimbursim të pjesshëm, receta pa rimbursim, formularë vizite, formularët e procedurave mjekësore, rekomandime, kartela, librezë shëndetësore të lëshuara nga institucione shtetërore, si dhe dokumente të prodhuara e të lëshuara nga njësitë e qeverisjes vendore, të cilat përmbajnë numër serial .

2.1 Nga data 1 janar 2025 e në vijim, autorizohet shoqëria “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”<sup>1</sup> sh.a., vetë ose nëpërmjet një shoqërie të krijuar prej saj, për prodhimin dhe shpërndarjen e pullave fiskale, sipas kuptimit në ligjin për akcizat në Republikën e Shqipërisë, kundrejt pagesës.

3.Procedurat, afatet dhe çështje të tjera, që lidhen me prodhimin e letrave me vlerë, rregullohen me udhëzimin e Ministrit të Financave që do të dalë brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

---

<sup>1</sup> Vendimi nr. 273, datë 2.5.2024, botuar në FZ. Nr.80 datë 9.5.2024 në pikën 2 të tij, shprehet: “Ministria e Financave i kalon pa pagesë shoqërisë “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”, të gjitha të dhënat dhe aktivet, të marra në dorëzim nga koncesionari, sipas përcaktimit të kontratës koncesionare “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të pullave fiskale”, ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive “SICPA Security Solutions SA” e “SICPA Security Solutions Albania sh.p.k.”, të miratuar me ligjin nr. 10381, datë 24.2.2011, dhe të ndryshuar me ligjin nr. 17/2023.”

4. Vendimet nr.402, datë 6.8.1993 “Për shtypjen e letrave me vlerë”, dhe nr.183, datë 28.3.2007 “Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave të transportit rrugor” të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**